



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Datë: 27 dhjetor 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 26 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1: të Ligjit Nr.08/L-167 për Prokurorin e Shtetit, nenit 12, 14, 16 dhe nenit 23 paragrafi 2 të Rregullores Nr.02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, si dhe në bazë të Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, KPK/Nr. 1006 /2023 të datës 22 dhjetor 2023, shpall:

SHPALLJE E BRENDSHME

Për plotësim me një (1) pozitë për prokuror në Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore në Prizren

- I. Prokurorët e Shtetit duhet të plotësojnë kriteret për avancim në Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore në Prizren si në vijim:
 1. Të jetë prokuror me mandat të përhershëm;
 2. Të ketë vlerësim të mjaftueshëm ose më të lartë të performancës;
 3. Vlerësimi "I mjaftueshëm" sipas Rregullores Nr. 12/2015 për Vlerësimin e Performancës të Prokurorëve të Shtetit është pengesë për avancim, deri në vlerësimin e prokurorit sipas Rregullores Nr. 05/2020 për Vlerësimin e Performancës të Prokurorëve të Shtetit;
 4. Të mos ketë masa disiplinore në pesë (5) vjetët e fundit, përjashtimisht qortimit dhe vërejtjes jopublike;
 5. Të mos ketë filluar hetimi penal;
 6. Të ketë reputacion të lartë profesional;
 7. Me rastin e avancimit do të merren parasysh pjesëmarrja në trajnime në fushën specifike që ndërlidhet me njohuritë e përgjithshme në procedurë penale, mjetet juridike, praktika juridike e gjykatave vendore dhe ndërkombëtare,

përgatitja akademike, punimet shkencore, ligjçrimi në akademi apo në nivel universitar, angazhimi i prokurorit në sistemin prokurorial dhe pjesëmarrja në projekte vendore ose ndërkombëtare në cilësinë e ekspertit dhe pjesëmarrja në ekipe hetuese.

II. Përveç kritereve të përgjithshme kandidatët që aplikojnë për avancim duhet të plotësojnë edhe kriteret e veçanta si në vijim:

1. Për të ushtruar funksionin e prokurorit në Departamentin për Krime të Rënda apo në Departamentin për të Mitur në Prokurorinë Themelore, prokurori duhet të ketë mandat të përhershëm si prokuror dhe vlerësim pozitiv të performancës.

III. Kandidati që aplikon për avancim duhet të plotësojë formularin për Avancim dhe Transferim të Prokurorëve të Shtetit¹ si dhe ti bashkëngjisin dokumentet si në vijim:

1. Vlerësimi i Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse për tre (3) vitet e fundit;
2. Çertifikatat e pjesëmarrjes në trajnime;
3. Dokumente apo të dhëna të tjera relevante ose objektivisht të verifikueshme, siç janë ato për njohjen e ndonjë gjuhe të huaj, mësimdhënia në nivel universitar, publikimet shkencore, pjesëmarrja në projekte vendore ose ndërkombëtare si ekspert dhe pjesëmarrja në ekipe hetuese të përbashkëta.

IV. Këshilli Prokurorial i Kosovës inkurajon prokurorët e gjinisë femërore dhe prokurorët nga radhët e komuniteteve jo shumicë që të aplikojnë.

V. Afati për dorëzimin e kërkesës është nga data 28 dhjetor 2023 deri më datë 11 janar 2024.

VI. Kërkesa duhet të dorëzohet te Koordinatorja për Emërim, Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit, znj. Ismije Maxhuni, në katin e gjashtë (6) ndërtesa e Prokurorit të Shtetit, rruga "Luan Haradinaj" - Prishtinë, zyra numër 602, të mbyllura në zarf, ose me postë.

¹ Prokurorët të cilët aplikojnë për avancim duhet të plotësojnë formularin për Avancim dhe Transferim të Prokurorëve të Shtetit të cilin mund ta gjejnë në linkun <https://www.prokuroria-rks.org/shpallje/183/332/> duke i bashkëngjitur dokumentet e kërkuara me Rregullore.